



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:098488

Datë: 02.12.2022

Numri i dokumentit: 03709295

C.nr.542/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania Kosovare për Distribuum dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A (KEDS), me seli në Prishtinë, rr. "Bulevardi Bill Klinton", nr.3, Distrikti në Prizren, kundër të paditurit K. (Sh) K. nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilin e përfaqëson me autorizim av. A.Sh. nga Prizreni, për shkak të kompensimit të dëmit material, vlera e kontestit 1639.52 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në mungesë të palës së paditur me datën 19.09.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuum dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A (KEDS), me seli në Prishtinë-Distrikti në Prizren.

II. DETYROHET i padituri K. (Sh) K. nga fshati Komuna e Prizrenit, që në emër të kompensimit të dëmit material për shkak të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, t'ia paguajë paditëses shumën në lartësi prej 1639.52 € me kamat ligjore nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi, si dhe në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj paditëses shumën në lartësi prej 30 euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor është mbajtur në mungesë së palës së paditur, konform nenit 423 parag.4 të LPK-së.

Paditësja Kompania Kosovare për Distribuum dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A (KEDS), me seli në Prishtinë, rr. "Bulevardi Bill Klinton", nr.3, Distrikti në Prizren, pranë kësaj gjykate ka parashtruar, padi kundër të paditurit K.(Sh) K. nga fshati Komuna e Prizrenit, për shkak të kompensimit të dëmit, përmes së cilës ka theksuar se me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.2138/2015 të datës 22.12.2016, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 18.02.2017,

këtu i padituri është shpallur fajtor për veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga nenin 320 i KP, ndërsa që paditësja për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontest të rregullt civil. Sipas padisë, e paditura, prej datës së pavërtetuar e deri më datën 24.08.2015, në lokalit të tij – biznesin në fshatin Komuna e Prizrenit, nga komisioni i autorizuar i paditësës ishte vërtetuar se e ka shfrytëzuar energjinë në mënyrë të kundërligjshme më saktësisht të konstatuar sikurse në aktgjykimin e lartcekur penal, kështu energjia e shpenzuar nuk është regjistruar me ç' rast distriktit të KEDS-it në Prizren, i shkakton dëm material në shumën prej 1639.52 euro andaj edhe nga gjykata është kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija, ashtu që të detyrohet i padituri që t'ia kompensojë dëmin paditësës në shumën e lartcekur, më gjerësisht sikurse në padi.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, e autorizuar e paditësës D.A. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadije si dhe provave të propozuara në padi, ndërkaq në fjalën përfundimtare ka shtuar se në këtë procedurë dhe pas administrimit të provave është provuar bazueshmëria e kërkesëpadije, për çka edhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovoj në tërësi si të bazuar, duke e detyruar të paditurën "KEDS" SH.A me seli në Prishtinë - distrikti në Prizren, që në emër të kompensimit të dëmit material si pasojë e veprës penale të shkaktuar të konstatuar me aktgjykimin e plotfuqishëm penal të lartë administruar, t'ia paguaj paditësës shumën në lartësi prej 1639.52 €, si dhe në emër të shpenzimeve procedurës për taksën e paguar gjyqësore, shumën prej 30 €.

Shqyrtimi kryesor është mbajtur në mungesa të palës së paditur, pasi që janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

I autorizuari i të paditurit e av. A.Sh. nga Prizreni, në përgjigjen në padi të parashtruar me shkrim pranë kësaj gjykate, si dhe në shqyrtim gjyqësorë e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësës. Në fjalën e tij përfundimtare, te dorëzuar gjykatës me shkrim thekson se nga Gjykata kërkon që të aprovojë në tërësi përgjigjen në padi dhe provat e bashkangjitura, si dhe deklaratimet në seancat gjyqësore, në atë mënyrë që të refuzojë padinë e paditësit KEDS - Distrikti në Prizren në lidhje me kompensimin e dëmit material me vlerë prej 1639.52 euro. Thekson se duke u bazuar në pajisjet energjetike të atëhershme dhe në këtë kohë nga eksperti i energjetikës, përkatësisht fotografitë e zhvilluara në vitin 2015, mund të vërehet se janë të njëjtat fotografi dhe se të njëjtat pajisje janë përdorur si depo nga lokali përdhese dhe se nuk kanë qenë funksionale as atëherë e as tani. Duke qenë se matjet e pajisjeve janë bërë më datë 06.08.2015, lind pyetja se si mund të shfrytëzohen kaloriferi dhe ngrohësja elektrike në muajin gusht, andaj, nuk ekziston mundësia e rikthimit të humbjeve në bazë të një logjike të thjeshtë se gjatë muajit gusht të vitit 2015 nuk ka qenë e mundur të përdoren pajisjet elektrike për ngrohje. Përderisa, paditësi e ka bërë llogaritjen në mënyrë paushallë, dhe pajisjet që kanë qëndruar në podrumin jo funksional akoma gjenden aty, e nuk janë në përdorim që nga viti 2013. Pretendimet e tij, bien në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike të datës 16.06.2016. Shkurtimisht, si konsumator, i padituri posedon listën e pagesave me të cilën dëshmon se është pagues i rregullt gjer më sot duke përfshirë edhe vitin 2016. Po

ashtu, nuk ka asnjë provë të vetme të llogaritjes së rikthimit të humbjeve për kalibrofer dhe ngrohësen elektrike në muajin gusht edhe pse që nga muaji gusht, ende para përpilimit të procesverbalit, pala e paditur i është drejtuar kompanisë KEDS për regjistrim por nuk janë përgjigjur që nga momenti i shkyçjes së energjisë elektrike në lokalin përdhësë. Nga faturat e palës së paditur, mund të vërehen vlera e përafërta ndërmjet faturave, por për dallim nga të tjerat shfaqet shuma prej 500 euro e jo si në padi, edhe pse shfrytëzimi ka qenë vetëm 3 ditor. Në anën tjetër, thekson se ka pasur edhe shkelje procedurale pasi duke e kundërshtuar edhe shqyrtimin gjyqësor që është mbajtur pa prezencën e palës së paditur, si dhe e kanë parë të nevojshme të merret parasysh edhe mendimi i palës së paditur lidhur me ekspertizën e elektroenergjisë, nevoja për të pyetur ekspertin lidhur me ekspertizën e prezantuar, e cila ekspertizë është punuar në mënyrë paushallë sipas provave të prezantuar nga paditësi KEDS, kurse nuk janë marrë parasysh provat e propozuara nga i padituri, nuk ka pasur kushte për të përfunduar kjo çështje gjyqësore. Gjithashtu, padia për kompensimin e dëmit të shkaktuar në vitin 2015, janë parashkruar dhe bien në kundërshtim me dispozitat e LPDTS dhe Ligjit për Energji Elektrike, me gjerësisht sikurse në fjalën përfundimtare të date 22.09.2022 .

Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.2138/2015 të datës 22.12.2016, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 18.02.2017, ka bërë leximin e faturës së paditëses me nr.DPZ15HP09882 i datës 07.09.2015., si dhe ka bërë shiqimin në ekspertizën, të ekspertit M.Gj. të dt.20.05.2022.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të tjera, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditëses është tërësisht e bazuar.

Në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm penal të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.2138/2015 të datës 22.12.2016, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 18.02.2017, gjykata e ka provuar faktin se këtu i padituri K.(Sh)K. nga Prizreni, është shpallur fajtorë pasi që ka kryer vepër penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK-së, me ç'rast paditëses i shkakton dëm material në shumën prej 1639.52 €, më gjerësisht sikurse në këtë aktgjykim.

Nga leximi faturën me nr. DPZ15HP09882 i datës 07.09.2015, gjykata ka konstatuar se dëmi të cilin e paditura i'a ka shkaktuar këtu paditëses është në shumën prej 1639.52 €, më gjerësisht sikurse në këtë faturë.

Nga shiqimi në ekspertizën, e ekspertit M.Gj. të dt.20.05.2022, gjykata ka konstatuar se fatura e rikthimit të humbjeve duhet të jetë 1639.52 euro.

Baza ligjore

Me nenin 154 al.1 të LMD-së, është paraparë se *“kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*. Sipas nenit 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se *“në procedurën kontestimore gjykata më pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”*. Po ashtu me nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se *“ palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, ndërsa që me nenin 7.2 të po këtij ligji decidivisht ceket se *“Gjykata është e autorizuar që t'i vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur, si dhe t'i marrë provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar me nenin 3 par.3 të këtij ligji)...”* gjë që sipas bindjes së gjykatës, në rastin në fjalë nuk kemi të bëjmë me kërkesa të tilla.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë është provuar se i padituri K.K. nga Prizreni, i ka shkaktuar dëm material këtu paditëses KEDS – Distrikti në Prizren, përmes shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, për çka i padituri ka detyrim për kompensimin e këtij dëmi ndaj paditëses. Në të vërtetë paditësi i ka ofruar gjykatës si provë aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren nr.2138/2015 të datës 22.12.2016, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 18.02.2017, përmes të cilit vërtetohet fakti se këtu i padituri është shpallur fajtorë për veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK-së, me ç' rast edhe është konstatuar shuma e dëmit të shkaktuar. Po ashtu paditësja si provë gjykatës i'a ka parashtruar edhe faturën mbi shpenzimin e paautorizuar të energjisë elektrike me nr. DPZ15HP09882 i datës 07.09.2015, e cila është hartuar konform rregullave dhe procedurave të aprovuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike (ZRREE), të cilës gjykata i'a fali besimin e plotë, e përmes të të cilave prova është vërtetuar lartësia e shumës së shpenzuar e energjisë elektrike në mënyrë të kundërligjshme nga ana e të paditurës, respektivisht lartësia e dëmit që i është shkaktuar këtu paditëses nga ana e të paditurës.

Gjykata duke u bazuar ne neni 358 të LMD-së ku parashihet se *“dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale*. Andaj konstaton se në bazë të aktgjykimit penal, dëmi ku është i shkaktuar paditësi nuk ka kulur siç parashihe me 30.11.2015, ku afati për parashkrimin e kësaj vepre penale është 6 vite prej kur eshët shkaktuar demi, ndërsa padia gjykatës i është deponuar me dt.03.10.2019, rrjedhimisht brenda afatit të parapare me ligjore. Me çka ka gjykata konstato se nuk kemi të bëjmë me përsëkrim në këtë çështje kontestimorte.

Ndërsa, lidhur me përcaktimin e dëmit real si në kërkesëpadinë e paditëse, gjykata e ka përcaktuar dhe vërtetuar edhe nga ekspertiza e ekspertit M.Gj. të dt. 20.05.2022, të cilës ekspertizë gjykata ia fali besimin.

Mbi bazën e të lartcekurave gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe se e njëjta duhet të aprovohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrur konform nenit 452 të LPK-së dhe atë vetëm për shpenzimet në emër të taksës gjyqësore në shumën prej 30 euro, siç edhe janë kërkuar nga ana e vet paditëses.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.542/2017, datë 19 shtator 2022

Gj y q t a r i,

Gëzim Shehu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.